



**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTLIGJIN “PËR INSPEKTIMIN NË REPUBLIKËN E**  
**SHQIPËRISË”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektligji është konsolidimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i veprimtarisë dhe sistemit të inspektimeve, për të siguruar mbrojtjen e interesit publik, forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtaritë e inspektimit, duke pasur parasysh të drejtat e subjektit të inspektimit.

Projektligji synon të garantojë pavarësinë funksionale të inspektorateve, rritjen e profesionalizmit, efektivitetit dhe performancës së trupave inspektuese nëpërmjet përdorimit të teknologjisë, si edhe duke vendosur parimet bazë të inspektimit me fokus programimin e inspektimeve dhe këshillimin dhe informimin e subjekteve të inspektimit lidhur me veprimtarinë inspektuese, në nivel qendror dhe vendor.

Projektligji adreson dhe ofron rregullimet e nevojshme ligjore për zgjidhjen e problematikave kryesore që janë hasur në fushën e inspektimeve si:

- Ekzistenca e një numri të madh institucionesh me funksione inspektuese, mos përcaktimi i një vije të qartë ndarëse të kompetencave dhe funksioneve të inspektimit, si edhe mungesa e bashkëpunimit ndërinstitutional në fushën e inspektimit;
- Mungesa e një procesi të përzgjedhjes së subjekteve të inspektimit në bazë të programimit dhe vlerësimit të riskut. Ekziston një praktikë e zgjedhjes së inspektimeve në mënyrë subjektive, e cila krijon hapësirë për abuzime dhe korrupsion;
- Sistemi aktual i marrëdhënieve të punësimit është me dy standarde për inspektorët - sipas Kodit të Punës dhe statusit të nëpunësit civil, duke krijuar një mungesë kohezioni në mënyrën se si trajtohen inspektorët. Në të njëjtën kohë, ky sistem aktualisht realizohet pjesërisht nga inspektoratet përkatëse ose Departamenti i Administratës Publike për

pjesën e rekrutimit dhe nga Inspektorati Qendror për pjesën e trajnimit dhe testimin, duke sjellë një mungesë harmonizimi në praktikat më të mira për të siguruar e rritur profesionalizmin e trupës së inspektimit;

- Veprimtaria inspektuese aktualisht karakterizohet nga mungesa e transparencës dhe efikasitetit, duke lënë hapësira për praktika korruptive dhe një barrë të rëndë administrative mbi biznesin. Bizneset kanë paqartësi dhe mungesë informimi për përmbushjen e kërkesave ligjore në fushën e inspektimit;
- Ushtrimi i veprimtarisë inspektuese ndikohet nga mungesa e pavarësisë në vendimmarrje dhe nga ndikimi politik, që dëmton integritetin dhe besueshmërinë e proceseve inspektuese;
- Është vërejtur mungesë e pavarësisë dhe e besueshmërisë nga subjektet e inspektimit tek komisionet e shqyrtimit të ankimit të dënimeve dhe masave administrative, të ngritura pranë inspektorateve përkatëse. Vetëm 6% e vendimeve përfundimtare të inspektimit i nënshtrohen ankimit administrativ nga subjektet e inspektimit;
- Ka mungesë të vlerësimit të performancës së inspektorateve në lidhje me ndikimin që ato kanë në përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushat përkatëse. Kjo sjell nevojën për të përcaktuar një metodologji specifike për matjen e performancës në bazë të ndikimit shoqëror që ka inspektimi përkatës (siç janë për shembull ulja e aksidenteve në punë, ulja e ndotjes mjedisore, etj.);
- Është vërejtur një numër i lartë i inspektimeve dhe i inspektimeve të paplanifikuara (rreth 40% e masës së inspektimeve totale), të cilat sjellin një barrë dhe kosto të konsiderueshme për biznesin;
- Vështirësi në zbatimin e ligjit nr. 10433/2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të lidhura kryesisht me arsye strukturore. Ky ligj nuk ka mundësuar vendosjen e një komunikimi të rregullt institucional midis Inspektoratit Qendror, inspektorateve të tjera dhe ministrive përgjegjëse në fushën e inspektimit. Vështirësi të tjera janë krijuar si pasojë e mbivendosjes së funksioneve të inspektimit në struktura të ndryshme, mos përmirësimi i sistemit elektronik të inspektimit, diskutimet e vendosjet e sistemeve të riskut në inspektorate specifike, organizimet e trajnimeve, etj.

Ky projektligj përmirëson në tërësi rregullimin e veprimtarisë së inspektimit duke përcaktuar e rregulluar:

- Parimet bazë të inspektimit;
- Riorganizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm, inspektorateve qendrore dhe vendore;
- Ngritjen dhe funksionimin e Bordit të Inspektimit, si organ këshillues, bashkërendues dhe përcaktues i politikave dhe standardeve të përgjithshme të inspektimit, me përfaqësues nga ministritë përgjegjëse në fushën e inspektimit;
- Marrëdhëniet e punësimit të inspektorit, ngritjen e sistemit të rekrutimit, karrierës dhe profesionalizmit nëpërmjet testimit, certifikimit dhe rritjes së nivelit të performancës së inspektorëve;
- Bashkërendimin dhe konsolidimin e proceseve të inspektimit, pa mbivendosje kompetencash ndërmjet organeve të ndryshme, si edhe përdorim më të mirë të burimeve njerëzore dhe publike në fushën e inspektimit;
- Dokumentet dhe procedurën e inspektimit;
- Këshillimin dhe lënien e detyrave në vizitën e parë në subjekt, ndërsa gjoba do të aplikohet në vizitën e dytë, nëse subjekti nuk ka reflektuar dhe rregulluar shkeljet sipas afateve të përcaktuara. Për shkeljet me natyrë të rëndë do të aplikohet pezullim aktiviteti.
- Përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit nga një burim qendror, i cili maksimizon dhe përshpejton fokusin në risqe, nxit bashkërendimin dhe ndarjen e informacionit në kohë reale, duke garantuar reagim të shpejtë dhe efektiv;
- Krijimin e një procesi transparent dhe të besueshëm për shqyrtimin e ankimit administrativ ndaj masave administrative të marra nga trupat inspektuese, duke e bërë pjesë të Inspektoratit të Përgjithshëm, duke shmangur konfliktin e interesit.

Ky projektligj synon të arrijë objektivat e mëposhtme:

- Objektivi parësor dhe gjithëpërfshirës i një reforme në fushën e inspektimeve është përmirësimi i klimës së biznesit. Sa më të qarta të

jenë bizneset për inspektimet, sa më të lidhura të jenë këto inspektime me riskun e këtyre aktiviteteve dhe mundësisë për shkelje dhe sa më transparente të jenë listat e verifikimit që përdoren nga inspektorët, aq më shumë do të krijohen kushtet për të realizuar në mënyrë të rregullt aktivitete biznesi.

- Inspektorati Qendror do të quhet Inspektorat i Përgjithshëm dhe do të marrë disa role shtesë në zbatimin e ligjit për inspektimin, në përputhje me nevojat për garantimin e ligjshmërisë në veprimtarinë inspektuese të inspektorateve shtetërore dhe vendore;
- Përmirësimin e veprimtarisë së inspektimit për garantimin e produkteve më të sigurta ushqimore dhe jo-ushqimore, një mjedis më të pastër, kushte më të sigurta pune, si edhe veprimtari ekonomike në fushën e energjisë dhe transportit në përputhje me detyrimet ligjore të subjekteve të inspektimit;
- Krijimin e mundësive për një riorganizim të inspektorateve në bazë të fushave të lidhura me risqet e ngjashme, në bazë të metodologjisë së sugjeruar nga OECD dhe e zbatuar në disa shtete ku ka pasur reforma thelbësore në këtë fushë, si në Francë, Holandë, etj.
- Mundësimin e bashkërendimit së të gjithë sistemit të inspektimeve nga një Bord Inspektimi, i përbërë nga përfaqësues politik të ministrive me përgjegjësi inspektimit, i cili do të marrë vendimet kryesore strategjike dhe përcaktues të politikave të inspektimit, që përfshijnë miratimin e standardeve dhe metodologjive për shumë aspekte të fushës. Modelet e një bordi të tillë janë përdorur në Holandë, Slloveni, Lituani si edhe janë pjesë e reformave të realizuara së fundi në këtë fushë në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut, reforma këto të realizuara me mbështetjen e BERZH (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim);
- Zbatimin e teknologjisë për të lehtësuar procesin e inspektimit, përfshirë kryerjen dhe raportimin e inspektimeve nëpërmjet sistemit unik elektronik të inspektimeve, duke ulur kohën e inspektimit dhe kostot për bizneset dhe administratën publike;
- Vendosja e një theksi të fortë në ndërtimin e një kulture parandaluese dhe edukative, duke vendosur paralajmërimin si dënim administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit, si dhe këshillimin mbi synimin për ndëshkim;
- Uljen e numrit të inspektimeve në subjektet e inspektimit, e cila sjell edhe uljen e barrës administrative si ulje e kostos në kohë/orë inspektimi pranë bizneseve (e pamatshme aktualisht sepse përfshin struktura që nuk kryejnë inspektim online), rritjen cilësore e procedurës së inspektimit, rritjen e konkurrueshmërisë dhe përmirësimin e klimës së biznesit;

- Rregullimin e marrëdhënieve të punësimit të inspektorëve, ngritjen e sistemit të rekrutimit dhe karrierës nëpërmjet testimit, certifikimit dhe rritjes së nivelit profesional sipas fushës së inspektimit;
- Kryerjen e inspektimeve bazuar në programe inspektive dhe vlerësimin e riskut të subjektit të inspektimit;
- Krijimin e një sistemi të qartë, të besueshëm dhe efikas për trajtimin e ankesave nga bizneset dhe individët në lidhje me veprimtarinë e inspektimit.

Efektet në lidhje me rezultatet e pritshme, referuar objektivave të sipërcituar, pritet të jenë të dukshme gjatë dhe në përfundim të vitit të parë të hyrjes në fuqi të ligjit për inspektimin dhe realizimit të riorganizimit vertikalisht dhe horizontalisht të trupave inspektuese.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” është produkti kryesor i grupit ndërinstitucional të punës në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 242, datë 29.12.2023, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për riorganizimin e inspektorateve”, me propozim të Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektligji garanton pavarësinë në vendimmarrje të trupave të inspektimit, në përputhje me parimet e inspektimit.

Numri i inspektimeve pritet të ulet me rreth 40%. Inspektimet e realizuara me trupa inspektuese të përbashkëta do të sjellin ulje jo vetëm të kostos në kohë/orë inspektimi pranë bizneseve, por edhe të kostos në përdorimin e burimeve publike.

Koha e qëndrimit në subjektin e inspektimit gjatë një viti kalendarik, për shkak të bashkërendimit të fushave të inspektimit, do të reduktohet ndjeshëm, pasi pjesë në përlllogaritjes do të jetë edhe koha e inspektimit të të gjitha strukturave inspektuese, që aktualisht nuk e kryejnë inspektimin në bazë të ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

Nën mbikëqyrjen e Inspektoratit të Përgjithshëm, raporti i inspektimeve të programuara dhe të paprogramuara, të hartuara dhe zbatuara nga Inspektoratet Qendrore, do të realizohet përkatësisht në masën 80% dhe 20%. Gjatë një viti kalendarik është përlllogaritur që numri i inspektimeve të paprogramuara të ulet nga 40% në 20%.

Koha që i duhet subjektit të inspektimit për t'u njoftuar paraprakisht për autorizimin e inspektimit do të rritet nga 3 në 7 ditë.

Përmes përmirësimit të kushteve të punës, synohet që të ketë një ndarje më racionale të detyrave e prioriteteve nga e njëjta adresë gjeografike, pajisje e mjete më cilësore elektronike e transporti për trupat inspektuese, burime njerëzore të përqendruara.

Siguri e garanci më e lartë në mbajtjen e ruajtjen e regjistrimeve të çështjeve të inspektimeve, si dhe ofruesin e shërbimit të internetit nga e njëjta qendër.

Ankimi i subjektit të inspektimit nuk do të shqyrtohet nga trupa kolegjiale të ngritura pranë organeve inspektuese, duke shmangur konfliktin e interesit. Inspektorati i Përgjithshëm do të garantojë shqyrtimin e ankimeve në formë transparente, bazuar në prova dhe fakte. Për rrjedhojë pritet që të shtohet besueshmëria e subjekteve të inspektimit tek procesi i rregullt i ankimit administrativ, duke ulur për rrjedhojë numrin e subjekteve të inspektimit që i drejtohen gjykatës administrative kompetente.

Efektet e pritshme të projektligjit kanë të bëjnë me përmirësimet cilësore në veprimtaritë inspektuese dhe konkretisht:

- a) do të garantohen inspektime me standarde bashkëkohore, me trupa inspektuese profesionale, me kushte më të mira pune, që ushtrojnë parimet e vendosura në ligjin për inspektimin;
- b) do të kryen funksione administrative më me eficiencë në kohë dhe cilësi nga riorganizimi i veprimtarive inspektuese;
- c) do të kryhen inspektime duke vendosur paralajmërimin si dënim administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit, si dhe këshillimin mbi synimin për ndëshkim;
- d) do të çojnë në ofrim të shërbimeve ndaj biznesit me standarde bashkëkohore, do të shmangen anshmëritë, dublimet dhe mbivendosjet e

kompetencave në procedurat inspektuese, duke ulur numrin aktual të inspektimeve;

- e) do të sigurohet rritje cilësore e kapaciteteve kontribuuese institucionale, si dhe e integritetit të trupave inspektuese, nëpërmjet një procesi rekrutimi të standardizuar, bazuar në nivele dhe në sistemin e karrierës për inspektorët;
- f) do të evitohet fryrja e strukturave të sektorëve mbështetës në inspektorate, drejtori, agjenci;
- g) do të sigurohet një administrim më efektiv, eficient dhe qasje më ekonomike në administrimin e fondeve publike, duke ulur rrezikun në sistemet e administrimit të burimeve njerëzore, sistemet e pagesave, sistemet e prokurimeve, sistemet e kontabilitetit dhe raportimit financiar, si dhe sistemet e programimit dhe zbatimit të buxhetit;
- h) ushtrim i kompetencave institucionale në mungesë të konfliktit të interesit;
- i) do të evitohen përplasjet e kompetencave midis inspektorateve qendrore, si dhe midis atyre qendrore me inspektoratet vendore;
- j) do të realizohet përzgjedhja e subjekteve për inspektim të bazuar në risk, i cili do të përfshijë të gjitha fushat e inspektimit, nëpërmjet sistemit unik të digjitalizuar të inspektimit;
- k) do të sigurohet akses i shpejtë në një informacion mbi të gjithë historikun e inspektimeve të subjektit;
- l) do të krijohet një regjistër unik kombëtar për dënimet administrative e vendosura dhe për të gjithë aktivitetet e regjistruara ekonomike;
- m) do t'i ofrohet biznesit një qasjeje më transparente e veprimtarive inspektuese, duke filluar nga ofrimi informacionit të nevojshëm për bizneset e reja, cilësia e inspektimeve e fokusuar në këshillim, thjeshtësia në aplikimet dhe përcjelljen e dokumentacionit të inspektimit në kohë reale, mungesa e inspektimeve të shpeshta.

### ***Për Inspektoratin Qendror:***

Ky projektligj paraqet nevojën për ndryshime në akte të tjera në fuqi si VKM nr. 630, datë 14.09.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit



Qendror”, në akte të tjera për riorganizimin e Inspektorateve Shtetërore, si dhe aktet për përfshirjen e strukturave inspektuese, që nuk ushtrojnë veprimtari inspektuese sipas ligjit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, VKM-së nr. 696/2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “*e-Inspektimi*”.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji i propozuar mbështetet në nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE***

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*).

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektligji përmban 12 krerë, të strukturuar në 72 nene.

**Kreu I** përmban dispozita të përgjithshme dhe përbëhet nga 4 nene.

*Neni 1* përcakton objektin e projektligjit, parimet e përgjithshme të inspektimit, unifikimin e veprimtarisë së inspektimit në nivel qendror dhe vendor, funksionet, rregullat dhe procedurat që zbatohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së inspektimit, si dhe marrëdhënien e punësimit, rekrutimit, trajnimit dhe ecurisë në karrierë të inspektorëve.

*Neni 2* përcakton qëllimin e projektligjit për mbrojtjen e interesit publik, forcimin e transparencës dhe llogaridhënies, përmirësimin të vazhdueshëm nëpërmjet këshillimit të subjektit të inspektimit si dhe rritjen e efektivitetit të administratës publike nëpërmjet përdorimit të teknologjisë në veprimtari të inspektimit.



*Neni 3* përcakton funksionet dhe rregullat për ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit në nivel qendror dhe vendor, me përjashtim të inspektimit të brendshëm me karakter administrativ në sektorin publik, auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe inspektimit financiar publik, inspektimit të autoritetit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, kontrollit doganor, inspektimit të lojërave të fatit. Projektligji zbatohet në veprimtarinë e inspektimit në fushën tatimore vetëm për verifikimin në terren, të parashikuar nga ligji për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

*Neni 4* parashikon përkufizimet si: dënim administrativ, ecuria në karrierë, inspektim, inspektorati qendror, inspektorati vendor, inspektim i programuar, inspektim jashtë programi, procedurë inspektimi, program vjetor i inspektimit, program mujor i inspektimit, subjekt i inspektimit, trupë inspektuese, ministri përgjegjës, sistem unik elektronik “*e-Inspektimi*”;

**Kreu II** përmban parimet e inspektimit dhe përbëhet nga 7 nene.

*Neni 5* parashikon parimin e pavarësisë së inspektimit sipas të cilit, trupa inspektuese brenda kompetencave të dhëna me ligj apo akte nënligjore, është plotësisht e pavarur në kryerjen e procesit të inspektimit dhe marrjen e vendimeve për inspektimet që kryen.

*Neni 6* parashikon parimin e proporcionalitetit në veprimtarinë e inspektimit, sipas të cilit trupa inspektuese realizon hetimin administrativ vetëm për aq sa është e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit dhe objektivave të inspektimit.

*Neni 7* parashikon parimin e programimit të inspektimeve, sipas të cilit çdo subjekt inspektohet mbi bazën e programit të inspektimit dhe rastet përjashtimore janë të përcaktuara në këtë ligj.

*Neni 8* parashikon parimin e dispozitës më të favorshme ligjore, parim sipas të cilit kur dispozitat e ligjit të posaçëm mbi bazën e së cilit realizohet procedura e inspektimit janë të paqarta apo bien në kundërshtim me njëra-tjetrën, trupa inspektuese mbështetet në dispozitat e këtij ligji dhe ndërmerr veprime që cenojnë më pak subjektin e inspektimit.

*Neni 9* parimi i këshillimit dhe informimit të subjektit të inspektimit parim sipas të cilit trupa inspektuese siguron këshillimin e subjektit të inspektimit për parandalimin dhe shmangien e shkeljes së kërkesave ligjore dhe e informon subjektin e inspektuar për të drejtat dhe detyrimet e tij në procesin administrativ të inspektimit dhe për pasojat ligjore të veprimeve apo mosveprimeve të tij.

*Neni 10* parashikon parimin e informimit të publikut dhe mbrojtjes së konfidencialitetit, sipas të cilit inspektorati informon publikun për konstatimet dhe masat e marra gjatë procedimit administrativ të inspektimit, nëse kjo është e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave fizikë e juridikë.

*Neni 11* parashikon parimin e transparencës, sipas të cilit inspektoratet shtetërore dhe vendore, e ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente, në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë.

**Kreu III** rregullon organizimin dhe funksionet e Inspektoratit të Përgjithshëm dhe përmban 7 nene.

*Neni 12* parashikon organizimin dhe funksionet e Inspektoratit të Përgjithshëm, si institucion publik qendror buxhetor me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit dhe që financohet nga Buxheti i Shtetit, burime të tjera të ligjshme dhe fonde publike në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ky nen parashikon edhe misionin i tij për përmirësimin dhe rritjen e nivelit të efektivitetit dhe përgjegjshmërisë gjatë kryerjes së veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

*Neni 13* përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit të Përgjithshëm, duke i ndarë në detyra dhe përgjegjësi të përgjithshme, detyra dhe përgjegjësi për inspektoratet qendrore si dhe detyra dhe përgjegjësi për inspektoratet vendore duke ruajtur parimin e autonomisë vendore.

*Neni 14* parashikon krijimin e Bordit të Inspektimit, pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, si organ këshillues, bashkërendues dhe përcaktues i politikave dhe standardeve të përgjithshme të inspektimit.

*Neni 15* parashikon emërimin, shkarkimin dhe lirimin e Inspektorit të Përgjithshëm i cili mbështetet nga një Zëvendësinspektor i Përgjithshëm, si dhe

përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë disiplinën, lirim dhe shkarkimin e tij.

*Neni 16* përcakton kriteret e emërimit të Inspektorit të Përgjithshëm.

*Neni 17* përcakton rastet e lirit dhe shkarkimit të Inspektorit të Përgjithshëm.

*Neni 18* përcakton përgjegjësitë e Inspektorit të Përgjithshëm.

**Kreu IV** përmban 2 nene dhe rregullon marrëdhëniet e punësimit dhe kriteret për emërimin dhe klasifikimin e inspektorëve.

*Neni 19* parashikon kryeinspektorin e inspektoratit qendror, emërimin, lirim dhe shkarkimin e tij, si dhe kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë dhe disiplinën.

*Neni 20* përcakton marrëdhëniet e punësimit, kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, si dhe rastet dhe procedurat për shkarkimin dhe lirim nga detyra të inspektorit, si dhe kriteret për emërimin në pozicionin inspektor.

**Kreu V** përmban 2 nene rregullon vlerësimin e inspektorit.

*Neni 21* parashikon ngritjen e komisionit të rekrutimit dhe ecurisë në karrierë, kompetencat e tij si dhe mënyrën e përcaktimit të rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisionit të Rekrutimit dhe Ecurisë në Karrierë.

*Neni 22* parashikon procedimin disiplinor dhe komisionin disiplinor.

**Kreu VI** përmban 2 nene rregullon trajnimin dhe testimin e inspektorëve.

*Neni 23* parashikon trajnimin dhe testimin e inspektorëve, moskalimi i testimit fillestar, moskalimi në testimin periodik si dhe mënyrën e përcaktimit të rregullave të hollësishme për afatet e testimit fillestar, intervalet e testimit periodik dhe rregullat për procedurën e provimit dhe kriteret përkatëse të vlerësimit.

*Neni 24* parashikon kryerjen e veprimeve të inspektimit nga inspektori në kohë prove.

**Kreu VII** përmban 5 nene rregullon organizimin dhe funksionimin e inspektorateve qendrore dhe vendore.

*Neni 25* parashikon inspektorateve qendrore, si institucione publike qendrore, përgjegjëse për zbatimin e politikave të veprimtarisë së inspektimit të ministrive sipas fushave përkasë të inspektimit të përcaktuara me ligj.

*Neni 26* parashikon krijimin, organizimin dhe funksionimin e inspektorateve qendrore, si dhe mënyrën e miratimit të strukturës dhe organikes së inspektorateve qendrore.

*Neni 27* parashikon përgjegjësitë e Kryeinspektorit qendror.

*Neni 28* parashikon Përgjegjësitë e Kryeinspektorit të drejtorisë rajonale.

*Neni 29* parashikon krijimi dhe drejtimi i inspektorateve në juridiksionin e njëjësive të qeverisjes vendore.

**Kreu VIII** përmban 2 nene dhe rregullon raportimin e inspektorateve qendrore dhe vendore.

*Neni 30* parashikon marrëdhëniet e inspektorateve qendrore me ministrinë përgjegjëse.

*Neni 31* parashikon marrëdhëniet e inspektorateve vendore me njësinë e qeverisjes vendore.

**Kreu IX** përmban 3 nene dhe rregullon rregulla të përgjithshme për programimin e inspektimit.

*Neni 32* parashikon inspektimin e programuar.

*Neni 33* parashikon inspektimin jashtë programi.

*Neni 34* parashikon Periudha maksimale e lejuar për inspektimet vjetore.

**Kreu X** përmban 13 nene dhe rregullon dokumentet dhe procedurën e inspektimit.

*Neni 35* përcakton autorizimin e një inspektimi.

*Neni 36* përcakton përmbajtjen e autorizimit.

*Neni 37* përcakton kohëzgjatjen e autorizimit.

*Neni 38* përcakton personat e autorizuar për të kryer veprime inspektimi.

*Neni 39* parashikon mbështetjen e veprimeve të inspektimit nga nëpunës, organe publike apo ekspertë e subjekte private të certifikuara.

*Neni 40* përcakton njoftimin e inspektimit, duke parashikuar edhe rastet përjashtimore kur nuk realizohet njoftimi i inspektimit.

*Neni 41* përcakton vendin dhe kohën e inspektimit.

*Neni 42* parashikon mënyrën e mbajtjes dhe njoftimit të procesverbalit.

*Neni 43* përcakton procedurën e shqyrtimit dhe marrjes së vendimit përfundimtar.

*Neni 44* përcakton paralajmërimin si dënim administrativ kryesor.

*Neni 45* parashikon shkeljen e dispozitave të tjera ligjore jashtë kompetencës së inspektorit, gjatë kryerjes së një inspektimi.

*Neni 46* përcakton masat urgjente.

*Neni 47* parashikon sistemin e-Inspektimi si sistemin unik elektronik të inspektimeve, si dhe mënyrën e qasjes dhe përdorimit, nëpërmjet moduleve të veçanta, nga organe të tjera publike me funksione inspektimi.

**Kreu XI** përmban 2 nene dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjektit të inspektimit.

*Neni 48* përcakton të drejtat e subjektit të inspektimit.

*Neni 49* përcakton detyrimet e subjektit të inspektimit.

**KREU XII** përmban 6 nene dhe përcakton të drejtat dhe detyrat e inspektorit.

*Neni 50* parashikon të drejtën e hyrjes dhe inspektimit në mjediset e veprimtarisë së subjektit të inspektuar.

*Neni 51* parashikon marrjen e mostrave nga trupa inspektuese, për qëllimin e inspektimit.

*Neni 52* parashikon marrjen e kopjeve dhe sekuestrimin e dokumenteve.

*Neni 53* parashikon mbështetjen nga organet e policisë së shtetit kur inspektori pengohet në kryerjen e detyrës.

*Neni 54* parashikon njoftimin e të tretëve, kur shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit janë kryer në mënyrë të tillë që cenojnë të drejtat apo interesat e ligjshëm të një personi të tretë.

*Neni 55* parashikon procedurën e funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimimit, i cili mblidhet sa herë që është nevojshme për të zhvilluar procedurën e shqyrtimit të ankimimit.

*Neni 56* parashikon procedurën e funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimimit pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, i cili mblidhet sa herë që është nevojshme për të zhvilluar procedurën e shqyrtimit të ankimimit.

**Kreu XIII** përmban 1 nen dhe përcakton kundërvajtjet administrative dhe klasifikimin.

*Neni 57* përcakton kundërvajtjet administrative dhe klasifikimin e dënimeve administrative për shkeljet e ligjit që kryhen nga subjektet e inspektimit.

**Kreu XIV** përmban 4 nene dhe parashikon dispozitat kalimtare dhe të fundit.

*Neni 58* parashikon dispozita kalimtare.

*Neni 59* përcakton aktet nënligjore që duhet të nxirren në zbatim të këtij projektligji.

*Neni 60* përcakton shfuqizimet e akteve ligjore.

*Neni 61* parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen për zbatim njësitë përgjegjëse: Inspektorati Qendror, Inspektoratet Shtetërore/Vendore, si dhe autoritetet dhe strukturat përgjegjëse, që kryejnë funksione inspektimi në nivel qendror dhe vendor, për zbatimin e këtij ligji, nën përgjegjësinë ose varësinë e institucioneve të mëposhtme:

1. Kryeministria
2. Ministria e Arsimit dhe Sportit
3. Ministria e Mbrojtjes
4. Ministria e Brendshme
5. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
6. Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit
7. Ministria e Financave
8. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
9. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
10. Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT**

Për të analizuar situatën aktuale të inspektorateve në Shqipëri është ngritur një grup pune me Urdhrin nr. 242, datë 29.12.2023, “Për ngritjen e grupit ndërinstitutional të punës për riorganizimin e inspektorateve”. Ky grup pune realizoi një analizë të kuadrit rregullator, një mbledhje të të dhënave, një analizë krahasuese me modelet e shteteve të tjera, duke dalë me një propozim për reformë.



Propozimi përfshin konsolidimin e inspektorateve aktuale në 8 Inspektorateve Qendrore, të organizuara mbi bazën e fushave të riskut, të mbështetur në modelin bazë të OECD-së për inspektimet, dhe në modelin francez dhe holandez të konsolidimit të inspektorateve.

Për të mbështetur hartimin e projektligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, është bashkëpunuar me përfaqësuesit e Shoqatave dhe Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë vendase e të huaja, si dhe është përdorur një asistencë teknike me ekspertë të UNDP.

Në të njëjtën kohë janë përdorur gjetjet nga raporti “*The system of inspections: recommendations for improvement*”<sup>1</sup>, i vitit 2020, i përgatitur për Grupin e Punës të lidhur me Reformat Strukturore të Qeverisë Shqiptare.

Eksperiencia ndërkombëtare është përfituar edhe nga realizimi i një vizite studimore në Ljubljana, Slloveni, ku janë kryer takime zyrtare me Këshillin e Inspektorateve të Sllovenisë dhe përfaqësues të inspektorateve kryesore, për të shkëmbyer informacione për eksperiencën sllovene në fushën e inspektimeve. Në vazhdim është zhvilluar një takim pune me Inspektoratin e Përgjithshëm të Kroacisë, ku janë diskutuar në detaje veçoritë e sistemit kroat të inspektimit.

Me këtë qasje, grupi ndërinstitucional, si dhe grupi ndërinstitucional teknik, i kryesuar nga Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror, finalizoi hartimin e projektligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me objektiv riorganizimin e trupave inspektuese qendrore (shtetërore), sipas fushave të inspektimit me funksione të ngjashme inspektuese, si dhe për një menaxhim dhe koordinim më të mirë të të gjithë inspektorateve shtetërore/vendore.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Përfitimi ekonomik për sektorin publik, konsiston në Ristrukturimin e Inspektorateve Shtetërore, i cili do të sjellë riorganizimin e strukturave në sektorët mbështetës (sektorët e burimeve njerëzore, juridike, financiare dhe shërbimeve mbështetëse), duke i grupuar në 8 Inspektorate Qendrore.

---

<sup>1</sup> *I mbështetur nga asistencë teknike e siguruara nga projekti “Support to the reform of subordinated institutions and agencies in Albania” – FWC SIEA 2018.*

Për realizimin e detyrave funksionale të Inspektoratit të Përgjithshëm kryhet riorganizim me disa sektorë të cilët do realizojnë funksionet shtesë të parashikuara në këtë projektligj, që lidhen me, këshillimin e biznesit dhe publikut, trajnimin e inspektorëve, testimin, disiplinën, vlerësimin e rritjes në karriere, si dhe ankimimin e aktit administrativ.

Për të realizuar këto funksione do të nevojitet në shtesë prej 60 punonjësish. Nga kjo shtesë nuk llogariten efekte financiare, pasi shpenzimet për këta punonjës do të mbulohen nga lëvizja e punonjësve të shërbimeve mbështetëse nga riorganizimi i Inspektorateve Qendrore.

Ndryshimet e këtij projektligji si pasojë do të sjellin dhe amendime në shtratin ligjor të inspektorateve shtetërore, si pasojë e riorganizimit.

***Përfitimet cilësore kryesore***, do të vijnë nga grupimi i të gjitha Inspektorateve Shtetërore në një strukturë të gjatë organizative, e cila do të rrisë bashkëpunimin e të gjitha trupave inspektuese dhe realizimin e inspektimeve të përbashkëta me kosto sa më të ulët administrative. Përmes optimizimit e racionalizimit të mjediseve, e ambienteve synohet koordinim më të mirë të ekipeve inspektuese të inspektorateve shtetërore; pajisje e mjete më cilësore transporti e elektronike për ekipet inspektuese; më tepër eficiencë e përgjegjshmëri në reagimin ndaj kërkesave të qytetarëve; nëpërmjet ndërveprimit të sistemeve online qytetari të bëjë një njoftim apo denoncim dhe ndjeka dhe marrja e përgjigjeve për kërkesën e tij; një kod më të mirë veshje, sjellje e performancë të inspektorëve; burime njerëzore më të përqendruara e me ekspertizë në rritje; garantim të trajnimit e kualifikimit dhe ecurisë në karrierë në vazhdimësi për të gjithë inspektorët, në të njëjtën vendndodhje; siguri e garanci më e lartë në mbajtjen e ruajtjen e regjistrimeve të çështjeve të inspektimeve, duke e patur infrastrukturën elektronike, si dhe ofruesin e shërbimit Internet nga e njëjta qendër nga i njëjti ofrues; mekanizma më të mirë për rritjen e përgjegjësisë së inspektorëve shtetërorë, lehtësi e bizneseve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe shkëmbim të informacionit në kohë reale, etj.

***Përfitimi ekonomik pozitiv*** për bizneset, përfshin krijimin e një klime të favorshme për zhvillimin e konkurrencës së ndershme, garantimin e rregullave të njëjta në treg, rritjen e investimeve të huaja dhe zhvillimin e ekonomisë në

tërësi. Do të ketë gjithashtu edhe disa lloje ndikimesh pozitive jo të drejtpërdrejta ekonomike të mundshme, duke përfshirë formalizimin e ekonomisë me synim, uljen e barrës administrative dhe uljen e korrupsionit.

Përveç ndikimit ekonomik, zbatimi i këtij projektligji do të ketë edhe ndikim social pozitiv jo të drejtpërdrejtë, i cili konsiston në rritjen e besimit tek qytetarët për funksionimin dhe zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve.

I bashkëlidhet paketës së projektligjit edhe Raporti i Vlerësimit të Ndikimit (RIA - Regulatory Impact Assessment), i cili shpjegon se miratimi i projektligjit parashikon të sjellë ndikime pozitive në buxhetin e shtetit.

## **PROPOZUESI**

### **MINISTRI I SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E BIZNESIT**

**Delina IBRAHIMAJ**